



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 20/2015

Prishtinë, më 26.5.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI**

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Sasha Milosavleviq, Sala Berisha-Shala, Blerim Grainca, Fatmir Rexhepi, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje- anëtarë.

Munguan: Besim Beqaj dhe Raif Qela - anëtarë.

Pjesëmarrëse e ftuar: znj. Hykmete Bajrami, ministre për tregti dhe industri.

Pjesëmarrës të tjerë: Rexhep Bllaca dhe Veli Hoti –MTI; Lejla Selimi-OSBE; Burim Ejupi – INDEP; Sabaudin Memi- Nosmo; Fatir Berzati-OJQ-Durchalten; Lirdon Lapashtica –Zëri; Visar Prebreza – Koha Ditore; Rudina Hoti – Express; Avni Uka- Bota Sot; Besim Toska Toskanapress. Info; Besa Berisha dhe Arta Xhylani – UNDP (praktikante).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.05.2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 05/L-039 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L- 029 për Patenta;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.05.2015

Procesverbal i mbledhjes së mbajtur më 19.5.2015 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 05/L-039 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L- 029 për Patenta

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa- Tha se për këtë pikë të rendit të ditës është e ftuar znj. Hykmete Bajrami, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe propozoi që së pari të paraqesë arsyetimin e Projektligjit Nr. 05/L-039 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L- 029 për Patenta dhe pastaj të hapim debatin.

Hykmete Bajrami, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë- Tha se fillimisht do ta paraqesë një ekspozë në pika të shkurtuara lidhur me qëllimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L- 029 për Patenta. Ajo theksoi se arsyetimi për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Patenta është sepse janë vërejtur disa pengesa praktike dhe vështirësi të natyrës së interpretimit dhe mospërshtatjes së disa neneve me Direktivat e BE-së. Prandaj me qëllim të zbatimit dhe qartësimit të plotë të Ligjit nr. 04/L-029 për patenta dhe me ndihmën e Agjencisë për Pronësi Industriale është vlerësuar nevoja e ndryshimit të ligjit për patenta, harmonizimin e tij me direktiva e BE-së, sidomos në pjesën që ka të bëjë me certifikatën e mbrojtjes suplementare dhe pjesën e zbatimi të të drejtave të patentës. Ajo tha se propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Patenta ndërlidhet me objektivat e Qeverisë respektivisht të MTI-së i cili ka për qëllim vënien e një kornize të qartë për mbrojtjen patentës në Kosovë. Po ashtu, ndryshimi dhe plotësimi i këtij ligji është i paraparë të realizohet në Planin e punës të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2014, si dhe në pajtim me Planin e Veprimet për Partneritet Evropian. Ajo tha se objektivi është krijimi i bazës ligjore për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për regjistrimin e patentës, të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi i certifikatës së mbrojtjes suplementare dhe zbatimi i këtyre të drejtave, si dhe përcaktimi i kompetencave dhe përgjegjësi të Agjencisë së Pronësisë Industriale. Me Neni 2 të Ligjit bazik nënparagrafi 1.3. fshihet, si dhe në tërë tekstin e Ligjit bazik emërtimi “Zyra e pronësisë industriale” (ZPI) - zëvendësohet me emërtimin Agjencia për Pronësi Industriale, tani e tutje (API). Po ashtu harmonizimi i Ligjit për Patenta me direktivat BE-së është kusht për Marrëveshjen Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian.

Kryetari- Tha se Ligji për Patenta është një ligj për nxitjen investimeve, rritjen e produktivitetit të konkurrencës dhe për rritjen e vetëdijes për mbrojtjen e patentave. Andaj, neve na nevojitet punë shumë e madhe për ruajtjen shpikjeve, sidomos në fushën e përparimit të teknologjisë. Ai theksoi sa i përket kalimit nga “Zyra e pronësisë industriale” në “Agjenci për Pronësi Industriale”, na duhet një arsyetim më i madh sidomos për Komisionin për Buxhet, për ne si Komision Funksional, nuk duhet të ketë shumë rëndësi emërtimi, por më rëndësi janë punët që duhet t’i kryej aty stafi.

Visar Ymeri – Tha se ky projektligj ndërlidhet edhe me ligjet e tjera të pronësisë industriale dhe shtoi se herën e kaluar kur janë shqyrtuar, janë shqyrtuar si një pako e ligjeve që përfshijnë edhe ligjin për markat tregtare, dizajnin industrial dhe më vonë edhe ligjin për treguesit gjeografik, andaj, do të duhej që edhe tash të vijnë në pako dhe të shqyrtohet komplet pakoja e këtyre ligjeve. Z. Ymeri pyeti se ky projektligj a po ndryshohet që të jetë në dobi të prodhimit vendor

apo atij nga jashtë? Duke shtuar se sipas informatave që ka rreth 90% e aplikacioneve vijnë nga jashtë. Lidhur me Agjencinë, z. Ymeri tha se raporti i auditorit thotë se Zyra për pronësi industriale është shndërruar në Agjenci për pronësi industriale pa u ndryshuar ligji. Po ashtu tha se është zgjedhur drejtori i Agjencisë, e cila Agjenci është bërë në mënyrë të paligjshme më 07.07.2013. Ai iu referua edhe një vendimi të ministres aktuale, e cila cakton U.D. të drejtorit të Agjencisë 13.03.2015 edhe pse dihej që Agjencia është krijuar në mënyrë të paligjshme. Deputeti Ymeri kërkoi nga ministrja Bajrami të arsyetojë këtë situatë?

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë – Duke u përgjigjur në pyetjet e deputetit Ymeri tha se duke u bazuar në Rregulloren e Qeverisë është bërë riorganizimi i MTI-së. Ajo shtoi se kemi shikuar praktikën e rajonit ku kemi gjetur se të gjitha vendet organet përgjegjëse për pronësi industriale kanë një lloj statuti të pavarur brenda ministrive, andaj edhe propozimi jonë është që të jetë Agjenci për pronësi industriale. Ministrja Bajrami shtoi se me ligjin për administratën shtetërore nuk ka më njësi organizative “Zyrë” dhe është dashur të bëhet riorganizimi i brendshëm i ministrisë. Më tutje znj. Bajrami sqaroi se ka caktuar U.D. të drejtorit të Agjencisë, sepse nuk ka dashur që të kthehet mbrapa, por të vazhdohet me kryerjen e punëve dhe ka vendosur një fusnotë së kjo çështje duhet të rregullohet me ligj. Ajo njoftoi se kur është bërë ministre, aty ka gjetur punëtorë me kontratë mbi vepër dhe në këtë Agjenci kanë qenë 13 mijë aplikacione në pritje, ndërsa tash janë angazhuar disa zyrtarë nga projekte dhe kanë mbetur rreth 4 mijë lëndë, e të cilat dihet afati kur do të kryhen, pra është shtuar efikasiteti i punës. Lidhur me dobinë e këtij projektligji znj. Bajrami shprehu mendimin se ky projektligj nuk është në disfavor të ekonomisë vendore. Në vazhdim ministrja Bajrami renditi disa sfida. Shfida është se sa institucionet tona mund ta zbatojnë ligjin, sfida po ashtu theksoi motivimin e shpikësve vendorë që shpikjen e tyre të patentojnë këtu, e jo jashtë vendit. Si sfida tjetër ministrja Bajrami e paraqiti edhe mungesën e njohurive nga shpikësit për ekzistimin e këtij institucioni për regjistrimin e patentave apo edhe ndoshta shpikësit nuk po i besojnë këtij institucioni.

Pal Lekaj – Tha se përveç ndryshimit që Zyra shndërrohet në Agjenci nuk ka ndonjë ndryshim tjetër që sjell ky plotësim ndryshim i ligjit për patenta. Ky projektligj më tepër është të mbulojë shkeljet e ish ministres, të mbulojë të gjithë atë çka ka ndodhur sesa të përmirësojë diçka, theksoi z. Lekaj. Dhe pyeti se ky projektligj a po vjen për të mbuluar ato veprime antiligjore apo për çka?

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë – sqaroi se ne me këtë projektligj nuk e kemi qëllim të mbulojmë asnjë shkelje, por shndërrimi i Zyrës në Agjenci vjen si rezultat i ndryshimeve ligjore me Ligjin për administratën shtetërore dhe mënyrën e organizimit të këtyre organeve në vendet e rajonit dhe po ashtu e kemi kusht edhe për MSA.

Fatmir Rexhepi – Tha se për organizimin e ministrisë duhet t’i japim përkrahjen ministres. Më pas shtoi se duhet të shohim si mund të punojmë që të krijohet korniza e nevojshme. Lidhur me këtë projektligj ai renditi tri çështje që ka për qëllim të rregullojë ky projektligj: 1. Duhet të behet harmonizimi me Direktiva të BE-së; 2. Çështja e Agjencisë duhet të përcaktohet me këtë ligj dhe 3. Rregullimi i materies së mbrojtjes së patentave duhet të rregullohet edhe për brenda vendit përmes këtij ligji.

Visar Ymeri – Tha se pohimi i ministrisë se plotësim ndryshimi po bëhet për shkak të përputhjes me legjislacionin e BE-së nuk qëndron sepse të gjitha Direktivat që përmenden në projektligj janë të viteve para se të miratohet ligji bazik më 2011. Dhe, nga kjo i bien që ose nuk e keni përputhur atëherë ligjin me Direktivat ose ekziston arsye tjetër për plotësim ndryshim të ligjit bazik. Po ashtu deputeti Ymeri, potencoi se praktika e mosdhënies së përgjegjësisë për shkeljet po bëhet normë. Dhe, Ligji për administratë shtetërore nuk është ligj bazik për patenta por ky ligj.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë – Sqaroi se me mijëra vendime janë lëshuar me emërtimin Agjenci e të kthehemi mbrapa e të vazhdojmë me emërtimin Zyrë shkakton probleme të mëdha. Dhe kërkoj nga deputet që nëse kanë zgjidhje lë të propozojnë.

Visar Ymeri – Pyeti se a mundet dikush me kontestua vendimin e Agjencisë? Apo çka ka ndodhur me ato vendime kur janë lëshuar si vendime të Zyrës?

Rexhep Bllaca, (MTI – Drejtor i Departamentit Ligjor) – Sqaroi se në fund të 2010 ka hyrë në fuqi Ligji për administratën shtetërore dhe ligjet e tjera duhet të jenë në përputhje me Ligjin për administratën shtetërore, sepse është Lex specialis për administratë. Në bazë të Ligjit për administratën shtetërore në vitin 2012 ku ka filluar reforma në administratë kemi përgatitur Rregulloren e brendshme për organizimin e ministrisë dhe e kemi dërgua në MAP dhe na është kthyer përgjigje për pranim të rregullores, tha z. Bllaca dhe iu premtoj deputetëve që do t'ua dërgojë Vendimin e MAP-it lidhur me organogramin e ministrisë.

Enver Hoti – Pyeti se a ju është kthyer përgjigje pozitive nga MAP-i për Rregulloren për organizimin e Ministrisë? Deputeti Hoti shtoi se nëse ju, si ministri, nuk jeni në gjendje t'i adresoni shkeljet e paraardhësit kjo është shqetësuese. Si do ta bëni më atraktive Zyrën për pronësi industriale në mënyrë që palët ta shfrytëzojnë këtë Zyrë?

Blerim Grainca – Pyeti se markat e huaja tregtare a regjistrohen në Kosovë? Po ashtu pyeti se a merr Kosova obligime financiare për mbrojtjen e markave dhe patentave të huaja?

Sala Berisha – Shala – Tha se sa i përket Memorandumit shpjegues të Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Patenta, Direktivat nuk janë përkthyer ne tekstin e gjuhës shqipe, ndërsa në gjuhën serbe janë të përkthyer. Pyeti a ka rast kur shpikësit nga Kosova kanë shkuar në Gjermani, apo në ndonjë shtet tjetër për të regjistruar patentën? Ajo theksoi se në MTI kemi plot parregullsi lidhur me Agjencinë edhe tani sa i përket kalimit nga “Zyra e pronësisë industriale” në “Agjenci për Pronësi Industriale” në MTI- lidhur me këtë Agjenci kemi edhe mos përputhje të mëdha nga aspekti ligjor, si dhe MTI është shndërruar në njëfarë ministrie e agjencie.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë- Tha se MTI-ja ka një fushë të gjerë të fushëveprimit, prandaj ka një numër më të madhe të Agjencive. Ajo tha se për çështje të parregullsive që ngritën nga ana e deputeteve që kanë ndodhur kur ajo nuk e ka udhëhequr këtë ministri, për këtë janë Prokuroria dhe Gjykata. Ndërsa, sa i përket zëvendësimit që është propozuar në Projektligj nga “Zyra e pronësisë industriale” në “Agjenci për Pronësi Industriale” këtë emërtim ju si Komision Funkcional mund të leni si të shihni të arsyeshme me një amendament dhe ashtu si të vendos Kuvendi ne pajtohem.

Pal Lekaj – Parashtroi pyeti z. Bllaca, se a është njoftuar ish- ministrja Mimoza Kusari –Lila, se me emërimin e kryeshefit te “Zyra e pronësisë industriale” së është duke bërë shkelje ligjore? Dhe, për kontrata mbi vepër të punëtorëve që ka pasur shumë të punësuar mbi këtë bazë a është njoftuar znj. Kusari – Lila që është duke vepruar në kundërshtim me ligjin për administratën shtetërore?

Rexhep Bllaca (MTI – Drejtor i Departamentit Ligjor) – Sqaroi se pas aprovimit të Ligjit për administratën shtetërore, Ministria e Administratës Publike, më anë të rregullores ka vendosur që të behët kalimi nga Zyra në Agjenci.

Kryetari – Tha se me Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Patenta, si përfundim mund nxjerrim disa konkludime si t'i mbrojmë prodhuesit vendor dhe investitorët e jashtëm nga keqpërdorimet e mundshme të patentave të tyre. Ai theksoi se e mbështesim MTI-në, për këto masa për të krijuar dhe për të mbrojtur shpikjet të reja dhe patentat, ndërsa për themelimin e “Agjencisë për Pronësi Industriale” tha që nga aspekti konceptuar është mirë të jetë Agjenci, sepse në sytë e investitorëve shihet si më e mirë dhe më serioze.

Pas debatit, Komisioni vendosi me 4 (katër) vota për dhe 4 (katër) abstenime, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Që Kuvendi në seancë plenare të merr qëndrim lidhur me Projektligjin Nr. 05/L-039 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L- 029 për Patenta.

2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji pas miratimit të parim nga Kuvendi do të jetë në këtë përbërje: Muhamet Mustafa, kryesues, Visar Ymeri dhe Sasha Milosavljeviq, anëtarë.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa i njoftoi anëtarët e Komisionit se do të mbahet më 27 maj 2015, prej orës 10.00 në Hotel Sirius, tryeza me temën “Diskutimi rreth amendamentimit të Ligjit për efikasitetin e energjisë” të cilën e ka organizuar Shkolla Politike PIPS.

Mbledhja përfundoi në orën 13:15

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit

Muhamet Mustafa